

UDHËZIM
Nr. 265, datë 5.12.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 5628, DATË 18.11.2016,
“PËR MIRATIMIN E RRJETIT TË LINJAVE NDËRQYTETËSE”

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 16 dhe 19, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016, “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

1. Pika 1 e nenit 4 ndryshohet si më poshtë:

“1. Ministria përgjegjëse për transportin, në bashkëpunim me Institutin e Transportit dhe organet e specializuara të kontrollit të transportit, të përcaktuara sipas kuadrit ligjor në fuqi, kryejnë në vazhdimësi monitorimin e zbatimit dhe funksionimit të rrjetit të linjave ndërqytetëse, sipas aneksit 1 të këtij udhëzimi”.

Neni 2

1. Shtojca A dhe B e udhëzimit, të shtuar me udhëzimin nr. 3917, datë 18.7.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016, “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, shfuqizohen. Bëjnë përjashtim linjat ndërqytetëse dhe oraret përkatëse, që janë miratuar në zbatim të vendimeve të formës së prerë të gjykatave.

2. Subjektet e transportit, të cilat janë pajisur me licenca dhe me certifikata për linjat e parashikuara në shtojcën A, të udhëzimit nr. 3917, datë 18.7.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016, “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse””, duhet t’i dorëzojnë ato pranë organit që i ka lëshuar, por jo më vonë se 15 ditë nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.